

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ministria e Mbrojtjes: 43 vatra zjarri në 24 orët e fundit, ja sa janë ende aktive – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/ministria-e-mbrojtjes-43-vatra-zjarri-ne-24-oret-e-fundit-ja-sa-jane-ende-aktive/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 16:50:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 09:22:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7708eb3cd9b1b425c84751c39af83e42070a1baed0e0ae42a48e9572ac8608e
TEKSTI	9e1540995a5f0640cdfef6fe18f07648aedf1b26517cd42b7fc3d65c92712dee4
PAMJA	b049a131e32115bb1dfbcaaa0ecc5abbe81dea7a185d977dbd55d6ad19b7fb8f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9b3b3332f301172f27ae25ae306ddd1254c81228154f89bca3f4c853023ae95f
E MËPARSHMJA	43a4bfd3ae4e8f3b9e57cbdd2b985b83f41261620050e205813c8b0fd8651368
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9b3b3332f301172f27ae25ae306ddd1254c81228154f89bca3f4c853023ae95f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



janë deklaruar të fikura.

Në operacione janë angazhuar 614 forca vendore/lokale, 355 efektivë të FA, 70 automjete zjarrfikëse vendore, si dhe mjete të FA; janë zhvilluar 4 operacione me helikopterë dhe 1 me avion Air Tractor.

Qarku Tiranë: Në Malin e Dajtit zjarri vijon aktiv në sipërfaqe me pyll ahu dhe shkurre. Në operacion janë angazhuar 25 zjarrfikës, 7 forca të ADM-së, 74 efektivë të Forcave të Armatosura me 10 mjete dhe 1 autoambulancë, si dhe 1 avion Air Tractor. Nuk ka rrezik për zonat e banuara. Ndërkohë, vatrat në Kryezi të Kavajës dhe Malin e Bërzhitës janë nën mbikëqyrje.

Qarku Dibër: Viojnë aktive katër vatra: në Vajkal të Bulqizës, në Lundre-Madhesh të Matit, në Qafën e Helmes në Fushë-Bulqizë dhe në Cerrujë-Mali i Allushit në Klos. Në Lundre-Madhesh janë angazhuar 33 forca vendore, të mbështetura nga 37 efektivë të FA me 3 mjete dhe 1 autoambulancë, ndërsa ka operuar edhe 1 helikopter i Forcës Ajrore. Për vatrat aktive nuk raportohet rrezik për zonat e banuara.

Qarku Lezhë: Mbeten aktive vatrat në Gallatë të Kurbinit dhe në Kalivaç-Zimaj-Kashnjet të Lezhës. Situata më intensive paraqitet në Kalivaç-Zimaj-Kashnjet, ku janë angazhuar 63 forca vendore e vullnetare dhe 132 efektivë të FA, me 7 mjete, 3 automjete zjarrfikëse dhe 2 autoambulanca; ka operuar edhe 1 helikopter i Forcës Ajrore. Rreziku për banesat është shmangur.

Qarku Elbasan: Vijon aktive vatra në Gurëshpatë, njësia administrative Polis. I ibrazhd. ku po operojnë forcat e MZSH I ibrazhd. Nuk ka rrezik për

5 Elbasani nuk ranë egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

zonat e banuara. Vatra në malin e Qukësit, Prrenjas, mbahet nën mbikëqyrje.

Qarku Shkodër: Mbeten aktive tre vatra kryesore: në Mnelë të Vogël, Vau-Dejës, në Bardhaj-Myselim, Shkodër, dhe në malin e Tërbunit, Pukë. Në Bardhaj-Myselim janë angazhuar strukturat vendore dhe 58 efektivë të FA me mjete zjarrfikëse e autoambulancë, ndërsa ka operuar edhe 1 helikopter i Forcës Ajrore. Në Tërbun operojnë 46 forca vendore e policore dhe 42 efektivë të FA me 6 mjete dhe autoambulancë. Në të dyja zonat nuk raportohet rrezik për banesat. Vatrën në Iballë dhe Bërdicë janë nën mbikëqyrje.

Qarku Vlorë: Vatra në Bolenë, Horë-Vranisht, Himarë, është nën mbikëqyrje nga forcat e MZSH Himarë. Vatra e riaktivizuar në Kropisht, Selenicë, është deklaruar e fikur.

Qarku Fier: Vatrën në Peshtan, Fier, dhe Çërrilë, Mallakastër, janë nën mbikëqyrje nga forcat zjarrfikëse, përkatësisht në sipërfaqe me ullishta dhe në pyll me pisha, lis e shkurre.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile vijon të ndjekë në mënyrë të pandërprerë situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Kapacitetet operacionale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave, pasurisë së qytetarëve dhe mjedisit.



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



VENDI

**"Smart City",
Kumbro: Kamerat...**

**Xhuljana
Zhuleku**

2 minuta
më parë



VENDI

**Nis shkolla, Kumbro
prezanton risitë në...**

**Xhuljana
Zhuleku**

14 minuta
më parë



VENDI

**Nis sezoni i ri shkollos,
680 nxënës më pak...**

**Xhuljana
Zhuleku**

1 orë më
parë



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.